



Prishtinë: 12.02.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1235\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2008\_12\_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020, nxori këtë:

### V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. R. nga Komuna e Shtinës, me shifër të konsumatorit DFE - 9044417 si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_2008\_12\_19** i datës 13.12.2019.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.01.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: korrigjimi plotësues i datës 27.06.2016 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk pajtohet me argumentet e DMK në ZRRE konsumatori ka lexime të rregullta, shpenzim të ulët dhe jeton jashtë vendit. KESCO në ankesë ka theksuar se faturimi/korrigjimi plotësues është bërë bazuar në raportin e qendrës së kalibrimit, ku konstatohet se njehsori është brenda kufijve të lejuar. KESCO në ankesë ka theksuar se faturimi është bërë vetëm në shpenzimin e regjistruar në njehsori dhe jo shtesë, si dhe pse nuk është bërë faturimi me kohë është se njehsori ka pasur displejin në prishje. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2008\_12\_19 i datës 13.12.2019 për konsumatorin M. R. me shifër DFE - 9044417.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi plotësues i datës 27.06.2016 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron pasi që korrigjimi plotësues i bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO për konsumatorin prej TL=4144



kWh dhe TU=2956 kWh, e që në total është shpenzim i energjisë elektrike prej 7,100 kWh, nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimet e konsumatorit dhe kjo vërtetohet edhe nga rrjedha e energjisë elektrike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk pajtohet me argumentet e DMK në ZRRE konsumatori ka lexime të rregullta, shpenzim të ulët dhe jeton jashtë vendit, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në analizën e përgjithshme të rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexime të rregullta mujore, por që në shumicën e periudhave kohore konsumatori ose ka pak shpenzim të energjisë elektrike ose është faturuar vetëm me taksë, për shkak që vetëm në periudha të caktuara kohore shkakton shpenzim të energjisë elektrike pasi që jeton jashtë vendit dhe kjo është e vërtetuar edhe në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0153366 të datës 28.09.2015 të përpiluar nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se konstatimi i organit të shkallës së parë të ZRRE se konsumatori ka lexime të rregullta të shpenzimeve të energjisë elektrike, shpenzim të ulët dhe se jeton jashtë vendit është plotësisht i saktë pasi që kjo argumentohet edhe me rrjedhën e energjisë elektrike, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0153366 të datës 28.09.2015.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se faturimi është bërë vetëm në shpenzimin e regjistruar në njehsori dhe jo shtesë, si dhe pse nuk është bërë faturimi me kohë është se njehsori ka pasur displejin në prishje, Bordi i ZRRE-së ka theksuar se bazuar në procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.8412 të datës 31.05.2016 konstatohet se njehsori elektrik nr. nr.73421649 nuk është në rregull, njehsori displayin e ka në prishje, ndërsa është brenda kufijve të lejuar të matjes, shihet qartë se njehsori elektrik nuk është në rregull dhe nuk mund të konstatohet se ai shpenzim i energjisë elektrike i faturuar shtesë është i saktë. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se përveç që procesverbalit të kalibrimit të cekur më lartë rreth konstatimit se njehsori nuk është në rregull, duhet theksuar se edhe korigjimi i kWh të faturuar nga KESCO për konsumatorin për periudhën 07/2015 deri në periudhën 09/2015 nuk mund të paraqesin shpenzimin real të konsumatorit, pasi që nuk përputhet me shpenzimet e konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M. R. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.